

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rusët dhe italianët “ia qëlluan”, prangosen dy të dënuarit nga GJKKO, trafikantin “Salvadore” dhe 47-vjeçarin që trafikonte njerëz (NJOFTIMI)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/ruset-dhe-italianet-ia-qelluan-prangosen-dy-te-denuarit-n-ga-gjko-tra-i401931
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:00:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 18:58:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	86f476d788257c1635e4cc5663bc483aa9d830b7daedf3fe9565d9e4a1de3b9e
TEKSTI	ae6c1afcc7e9f16950af602015da6cc50a4282bb1abea3563702706e391c8886
PAMJA	ca3f81ebb8d44972c3ab9cc579666fc3935ace14bc48576e58c291be82a7b6c9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fe62363d4459c2d77669f8f0eb55ca0c42846448b8ec5e34761c8c4e58fd34c9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/fe62363d4459c2d77669f8f0eb55ca0c42846448b8ec5e34761c8c4e58fd34c9

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

23 Shtator 2026, 20:58

Rusët dhe italianët "ia qëlluan", prangosen dy të dënuarit nga GJKKO, trafikantin "Salvadore" dhe 47-vjeçarin që trafikonte njerëz (NJOFTIMI)



Shkruar nga Newsbomb



Policia e Shtetit

Policia e Shtetit ka dalë me reagim zyrtar në lidhje me arrestimin e trafikantit të shumëkërkuar të SPAK për të cilin, si dhe raportuam, thekson se Shpëtim Aliu është vënë në pranga në Rusi ndërsa pritet që të esktradohet drejt Shqipërisë.

"Shpëtim Aliu, 51 vjeç, i kapur në Rusi. Për të, në qershor të vitit 2026, Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg" për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal" shkruhet në njoftimin e bërë nga Policia e Shtetit.

Po ashtu, blutë e Shqipërisë sqarojnë se falë Operacioni të koduar "The Wanted" i cili u zhvillua në dy faza, si rezultat i shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit operacional mes specialistëve të Drejtorisë së Interpolit dhe strukturave partnere ndërkombëtare, janë vënë në pranga dy persona të kërkuar ndërkombëtarisht për veprimtari kriminale në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike dhe kalimit të paligjshëm të emigrantëve.

Njëri prej tyre është trafikanti i shumëkërkuar i drejtësisë shqiptare, Shpëtim Aliu, për të cilin GJKKO ka caktuar "arrest me burg" për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar

Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Bota

Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Politikë

"Shteti i gysrave" Sallanji "shpërthen" pas arrestimit të sheshtes së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGIMI)

Zbulu më shumë artikuj

kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Po ashtu bëhet me dije se në pranga është vënë dhe shtetasi Alok Mittra, 47 vjeç, i cili rezultoi se në vitin 2024 GJKKO e ka dënuar me 15 vite burgim për veprat penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Falsifikimi i dokumenteve", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Sipas hetimeve, 47-vjeçari Alok Mittra i cili u prangos në Itali, dyshohet se ka qenë pjesë e një grupi kriminal që gjatë viteve 2023-2024 organizoi kalimin e paligjshëm të kufirit për rreth 253 shtetas nga Bangladeshi, kundrejt përfitimeve financiare.

Këshilluar për ty



GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)

Njoftimi i plotë i Policisë:

Si rezultat i bashkëpunimit informativ dhe operacional ndërmjet specialistëve të Drejtorisë së Interpolit dhe homologëve të Interpol Moskës dhe Interpol Romës, gjatë këtyre 2 fazave të operacionit të koduar "The Wanted", u arrestuan provizorisht, me qëllim ekstradimin në Shqipëri, shtetasit e kërkuar ndërkombëtarisht:

-S. A., 51 vjeç, i kapur në Rusi, të cilit, në muajin qershor, 2026, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar i ka caktuar masën e sigurisë "Arrest në burg", për veprat penale "Trafikimi i narkotikëve", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

-Alok Mittra, 47 vjeç, i kapur në Itali, të cilin, në vitin 2024, Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar e ka dënuar me 15 vjet burgim, për veprat penale "Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve", "Falsifikimi i dokumenteve", "Grupi i strukturuar kriminal" dhe "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal".

Nga hetimet rezultoi se 47-vjeçari ishte pjesë e një grupi kriminal, i cili për 6 muaj në vitet 2023-2024, organizoi kalimin e kundërligjshëm të kufirit, të rreth 253 shtetasve nga Bangladeshi, kundrejt përfitimeve financiare. Shtetasit e huaj sillleshin në Shqipëri, nga Dubai, dhe nënshkruanin kontrata pune fiktive për t'u pajisur me leje qëndrimi. Sapo pajiseshin me këtë dokument, ata niseshin drejt shteteve të BE-së. Gjatë itinerarit të kësaj veprimtarie kriminale, shtetasi Alok Mittra shoqëronte shtetasit e huaj dhe merrej me transportimin dhe akomodimin e tyre.


Në bashkëpunim me homologët në Moskë dhe në Romë, Interpol Tirana vijon procedurat për ekstradimin e të dy shtetasve, në Shqipëri.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu





🕒 E Mërkurë 20:27 Newsbomb

GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)



Aktualitet

Kryeqyteti pret të dielën "Triathlon", në fundjavë do të ketë bllokime rrugësh, ja cilat zona do të "paralizohen"

🕒 E Mërkurë 19:54



Aktualitet

Aksident i dytë brenda ditës në Durrës, makina përplas qytetarin me skuter elektrik

🕒 E Mërkurë 19:14



Aktualitet



🕒 E Mërkurë 18:39 Newsbomb

Duraj tha se Bleona Mata është gjallë, nëna "e helmuar" nga deklarata e tij e paralajmëron: Do të ndjek penalisht! Reagon dhe SPAK



Aktualitet

KED lejon tre kandidatë të vazhdojë garën për Gjykatën Kushtetuese,



Aktualitet

Parkimi në rrugët e Durrës bëhet me lekë, ja sa do të paguajnë qytetarët



E Mërkurë 17:35 Newsbomb

E RËNDË në Dibër, efektivi i Policisë ndalohe për dhunë fizike ndaj një vajze dhe vëllait të saj të mitur (DETAJE)



Aktualitet

Behgjet Pacolli publikon FOTO me dy miqtë e tij nga Nju Jorku, por puna që ata bëjnë mund ta ndihmojë shumë për Aeroportin e Vlorës

E Mërkurë 17:07



Aktualitet

SPAK zbardh kërkesën: Shefja e SHISH do të merret në pyetje mesditën e nesërme, dy të tjerët në orën 9 të mëngjesit (DETAJE)

E Mërkurë 16:44 Newsbomb



E Mërkurë 15:49 Newsbomb

Sërish zjarr në Vlorë, vatra e tretë për sot, rrezikohet spitali i qytetit dhe banesat, detajet e para





Aktualitet

Nesër seancë plenare, mobilizohen studentët! Paralajmërojnë protestë para Parlamentit, ja "porosia" që i lënë njëri-tjetrit



🕒 E Mërkurë 15:29



Aktualitet

Ky është 50-vjeçari që humbi kontrollin e motorit, u rrëzua dhe vdiq në Lezhë, la pas gruan, dy djem e dy vajza (EMRI-FOTO)

🕒 E Mërkurë 15:30 Newsbomb



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.